**V E N D I M**
**Nr.24,datë 30.7.2003**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj SauliAnëtar i ““
Alfred Karamuço Anëtar i ““
Kristofor Peçi Anëtar i ““
Kujtim Puto Anëtar i ““
Xhezair ZaganjoriAnëtar i ““
Petrit PlloçiAnëtar i ““
Sokol SadushiAnëtar i ““
Zija Vuci Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.4.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.23 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MIRDITË
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KËSHILLLI I MINISTRAVE, në mungesë
2. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zotërinjtë Ilir Shurdhi e Gëzim Veleshnja, këshilltarë të Departamentit Juridik, me autorizim.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 375 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale”
BAZA LIGJORE: Neni 145/2 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë

Kërkuesi ka parashtruar se kjo dispozitë e Kodit të Procedurës Penale, vjen në kundërshtim me nenin 31 shkronjat “a” e “b” të Kushtetutës. Mënyra e formulimit të saj nuk i krijon mundësi të pandehurit të njihet hollësisht me përcaktimin e ri të faktit të bërë nga gjykata, nuk i lë atij kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe për ta ndërtuar atë në përshtatje me ndryshimin e akuzës. Pozita e tij rëndohet veçanërisht kur ky ndryshim shoqërohet me zbatimin e një ligji material, që përmban dënim më të rëndë, sepse gjykata, pas diskutimit përfundimtar të palëve, nuk ka të drejtë të riçelë seancën gjyqësore.
Në këto rrethana, kërkuesi duke cituar edhe qëndrimin që ka mbajtuar Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.50, datë 30.7.1999, kërkon shfuqizimin e dispozitës së lartpërmendur të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, pas mbylljes së hetimit gjyqësor dhe diskutimeve përfundimtare, është tërhequr në dhomën e bisedimeve dhe ka vendosur pezullimin e gjykimit për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Llesh Mark Lekëgegaj. Në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, kjo gjykatë, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimin si antikushtetues të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, duke çmuar se kjo dispozitë, vjen në kundërshtim me nenin 31 shkronjat “a” e “b” të Kushtetutës.
Ushtrimin e kësaj kërkese gjykata e ka argumentuar me nevojën që i ka lindur në këtë fazë gjykimi, për të ndryshuar cilësimin juridik të njërës prej veprave që i atribuohen të pandehurit.

Organi procedues në kërkesën e tij për gjykim, e ka cilësuar atë si vrasje me paramendim në dëm të dy personave, të mbetur në fazën e tentativës. Mbi këtë bazë, ai ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zbatohet dy herë neni 78 në kombinim me nenin 25 të Kodit Penal. Cilësimin ligjor të kësaj vepre, gjykata e ka vënë në dyshim dhe ka biseduar mbi nevojën për t'i dhënë këtij fakti një përcaktim tjetër juridik.

Për ta realizuar këtë, gjykata i është referuar nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, ka bërë interpretimin e përmbajtjes së tij dhe ka dalë me konkluzionin se për shkak të ndryshimeve që ka pësuar kjo dispozitë, asaj si gjykatë e shkallës së parë, pas tërheqjes në dhomën e bisedimeve, i lejohet që këtë problem juridik ta zgjidhë vetëm me vendim përfundimtar, se nuk ka të drejtë të dalë me vendim të ndërmjetëm, të riçelë seancën gjyqësore për t'u komunikuar palëve ndryshimin e cilësimit juridik të veprës dhe të dëgjojë pretendimet e tyre. Këto ndalesa, sipas gjykatës, rëndojnë pozitën e të pandehurit për shkak se këtij i hiqet mundësia të njihet hollësisht me akuzën e re të ndryshuar dhe nuk i sigurohen koha e lehtësitë e mjaftueshme për të organizuar e realizuar mbrojtjen.

Në radhë të parë, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të sqarojë se shqyrtimi i kësaj çështje, sipas objektit të lartpërmendur nuk ka lidhje me vendimin e saj nr.50, datë 30.7.1999. Kjo, për arsye se shkaqet e parashtruara në këtë kërkesë janë krejt të ndryshme, ndërsa dispozita objekt i këtij gjykimi ka pësuar ndryshime thelbësore me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002.

Duke e parë çështjen në dritën e këtyre ndryshimeve, si dhe të pretendimeve të parashtruara, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, është e pabazuar.

Gjykata Kushtetuese nuk pajtohet me këto argumente dhe ripohon se gjykata e zakonshme nuk është organ akuze, nuk formulon akuzë dhe as e ndryshon atë, por mbi bazën e faktit të paraqitur bën cilësimin e duhur ligjor të veprës duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër. Në këtë rast, ajo bën intepretimin e ligjit që zbaton, gjë që është në kompetencën e saj. Pozita e të pandehurit nuk rëndohet edhe kur cilësimi i ri i veprës është më i rëndë, sepse rëndimi i pozitës trajtohet në raport me shkallën më të lartë të gjykimit. Në zgjidhjen e çështjeve konkrete, gjykata e zakonshme, ushtron funksionin e saj juridiksional, sqaron kuptimin e ligjit që duhet të zbatojë, me qëllim që të eleminojë çdo dyshim që lidhet me cilësimin juridik të veprës, për të siguruar kështu stabilitetin e së drejtës dhe rivendosjen e rendit juridik të shkelur.

Siç u tha edhe më lart, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, ka pësuar ndryshime. Fjalët "duke vënë në dijeni palët" si detyrim për gjykatën nuk figurojnë më në formulimin e ri të kësaj dispozite. Ky ndryshim nuk sjell si pasojë papajtueshmërinë e kësaj dispozite, me nenin 31 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese çmon se dalja e gjykatës në seancë gjyqësore dhe vënia në dijeni e palëve për mënyrën e zgjidhjes së këtij problemi ligjor, pa u shprehur kjo më parë me vendim përfundimtar, mund t'iu krijojë atyre dyshime për paragjykimin e çështjes nga ana e saj, gjë që mund të shoqërohet me një shkelje tjetër kushtetuese që lidhet me mosrespektimin e së drejtës themelore të individit për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e paanëshme.

Gjykata Kushtetuese nuk pajtohet as me konkluzionet e tjera të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Mirditë. Në kërkesën e saj ajo ka parashtruar si argumente për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale edhe përmbajtjet e neneve 372, 373 e 374 të këtij Kodi, ndonëse nuk ekziston ndonjë lidhje midis tyre. Kjo për arsye se këto të fundit parashikojnë rastet kur ndryshon fakti që përmendet në kërkesën për gjykim, d.m.th., kur gjatë procesit gjyqësor dalin vepra penale ose rrethana të reja në ngarkim të të pandehurit. Shqyrtimi i këtyre veprave së bashku me akuzën fillestare në një proces të vetëm, nuk mund të vendoset kryesisht nga gjykata, por vetëm me kërkesën e prokurorit dhe në rastin e daljes së një fakti të ri, edhe me pëlqimin e të pandehurit.

Në dallim nga kjo, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon rastet kur fakti që i atribuohet të pandehurit nuk ndryshon dhe mbetet i njëjtë deri në momentin e tërheqjes së gjykatës në dhomën e bisedimeve.

Në një rast të tillë, është gjykata ajo që çmon dhe vendos kryesisht për t'i dhënë këtij fakti një përcaktim tjetër, të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI PARALEL

Ashtu si shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, jam edhe unë për rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, por me tjetër arsyetim.

Neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, nuk ka lidhje dhe nuk i bëhej pengesë kësaj të fundit për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 20.10.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ajo nuk duhej të pezullonte gjykimin dhe t'i kërkonte Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dispozitës objekt kërkese.

Ky konkluzion imi gjen mbështetje të plotë në materialin që ndodhet në dosjen gjyqësore të krijuar nga vetë kjo Gjykatë e zakonshme. Nga aktet del se nevoja për ndryshimin e cilësimit të veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë në dëm të dy personave e kryer kjo nga i pandehuri Llesh Mark Lekëgegaj, asaj nuk i ka lindur pas tërheqjes në dhomën e bisedimeve. Përkundrazi, vetë prokurori që ka marrë pjesë në gjyq, në datën 14.2.2003, ka kërkuar i pari që këtij fakti t'i jepet një përcaktim tjetër, i ndryshëm nga ai që ka bërë organi procedues në kërkesën e tij për gjykim.

Mbi kërkesën e avokatit të të pandehurit, gjykata ka vendosur shtyrjen e gjykimit për në një ditë tjetër, për të hetuar gjendjen mendore të këtij të fundit. Pasi kjo detyrë është kryer nga ekspertët, seanca e fundit ku janë shqyrtuar konkluzionet e tyre dhe është mbyllur hetimi gjyqësor, është zhvilluar në datën 17.2.2003. Përsëri gjykimi është shtyrë për t'i dhënë palëve kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.

Në datën 14.1.2003, është çelur seanca gjyqësore për të dëgjuar konkluzionet përfundimtare të palëve. Si prokurori, ashtu edhe avokati i të pandehurit janë shprehur për ndryshimin e cilësimit ligjor të kësaj vepre, por secili ka kërkuar që ky ndryshim të realizohet duke zbatuar dispozita të ndryshme të ligjit material; prokurori nenin 79 shkronja "dh", ndërsa mbrojtësi i të pandehurit dy herë nenin 76 të Kodit Penal. Pra, në rastin konkret, të pandehurit i janë siguruar të drejtat që parashikohen në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 31 të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, me pretendimin se ky përbën shkak për shkeljen e këtyre të drejtave, në fakt nuk qëndron dhe si i tillë duhet rrëzuar.

A N Ë T A R I
Z. Vuci